



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 17 Prot.

Tiranë, më 30/05/2024

V E N D I M

Nr. 8, datë 30/05/2024

PËR

MIRATIMIN E FORMATIT TË FLETËVE TË VOTIMIT

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese 2024 – 2028, në Universitetin Politeknik të Tiranës”, neni 31, pika 4, si dhe vendimin nr. 1, datë 20/05/2024 të KIZ” Për konstituimin e Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ) në Universitetin Politeknik të Tiranës, si dhe zgjedhjen e kryetarit të tij”, në mbledhjen e datës 30.05.2024 Komisioni Institucional i Zgjedhjeve,








VENDOSI:

1. Të miratojë formatin e fletëve të votimit për zgjedhjet për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës si më poshtë:
 - Fletët e votimit duhet të jenë prej letre me ngjyrë dhe të kenë trashësi që të mos lejojë leximin e votës në pjesën e pasme të tyre. Letra e përdorur duhet të ketë peshë minimale 120 gr për metër katror.
 - Përmasat e fletës së votimit janë 180 x 320 mm.
 - Fletët e votimit prodhohen në blloqe me kod unik për secilën tipologji dhe pa kundra fletë.
2. Fleta e votimit në pjesën e përparme duhet të përmbajë:
 - Logon e UPT-së, intestimin “Republika e Shqipërisë, Universiteti Politeknik i Tiranës”, si dhe emërtesa për të cilën do të përdoret fleta e votimit.
 - Emërtimi i autoritetit drejtues, Senatit Akademik ose Komisionit të Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”;
 - Emri, atësia, mbiemri për kandidatët e regjistruar për autoritetet ose organet drejtuese, të cilët renditen sipas rendit alfabetik;

- Në rastin kur për autoritetin drejtues ose organin drejtues është regjistruar dhe konkuron vetëm një kandidat, në fletën e votimit krahas emrit të tij vendosen alterantivat për votim “Pro” ose “Kundër”;
 - Fleta e votimit për personelin akademik në sfond të saj ka të shkruar “Personel Akademik”, ndërsa fleta e votimit për studentët në sfond të saj ka të shkruar “Për student”.
3. Në faqen e prapme të fletës së votimit vendoset shkrimi “Vula KZF/KQV” dhe poshtë tij ka një rreth për pozicionimin e vulës së KZF/KQV me diametër rreth 5 cm. Gjithashtu për personelin akademik në sfond të saj ka të shkruar “Personel Akademik”, ndërsa për studentët ka të shkruar “Për student”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Edmond PERGEGA	Kryetar	
Alfred PJETRI	Anëtar	
Albina BASHOLLI	Anëtar	
Anjeza DULAJ (GJINI)	Anëtar	
Nelda KOTE	Anëtar	
Irida GJOKA (MARKJA)	Anëtar	
Klajdi QOSHI	Anëtar	
Pietro BELBA	Anëtar	
Lidia HYSA	Anëtar	